

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | 40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fiktive përmes kompanisë Colombo, skema dhe emrat                                                                                                                                                                                                                               |
| ADRESA  | <a href="https://prapaskena.com/2026/09/26/40-milione-euro-tendera-kush-eshte-fierakja-diana-laba-qe-vjedh-parate-e-bashkive-me-punime-fiktive-permes-kompanise-colombo-skema-dhe-emrat/">https://prapaskena.com/2026/09/26/40-milione-euro-tendera-kush-eshte-fierakja-diana-laba-qe-vjedh-parate-e-bashkive-me-punime-fiktive-permes-kompanise-colombo-skema-dhe-emrat/</a> |
| BURIMI  | prapaskena.com                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 10:43:52 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 10:31:20 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 72c2f5374bc4deb540cb38ee72d4e3a67989934012fc42ecdc9a925d9b16efa7 |
| TEKSTI     | 516f801f43778915c6f3a934e1333e06e1c59334d5cee89f4c082493e3fb6083 |
| PAMJA      | ecb75b3b7b15b9db555647767cdacaccf009bacfa24e8ebf4941c8cd548856ae |

## ZINXHIRI I PROVËS

|                |                                                                                                 |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE      | fb291c9b09ceff4d5044b36c5817b64976a8442a333335fa78819eaa40b45df0                                |
| E MËPARSHMJA   | —                                                                                               |
| RRËNJJA MERKLE | 2f94de55f91080d406fb9f0e4354ffa5a46214db9e0928186c4866f36bf6cd6f                                |
| ANKORIMI       | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fb291c9b09ceff4d5044b36c5817b64976a8442a333335fa78819eaa40b45df0>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



# 40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fiktive përmes kompanisë Colombo, skema dhe emrat

Investigim

Publikuar: 26/09/2026

f X



Sot ne daten ...21.02.2000 para meje noteres Adelina Panajoti u paraqiten personalisht palet : --

**SHITES :** Hasan Laba , i biri i Lulos , dtl. 1961 , lindur ne Vlore e banues ne Fier , njohur nga leternjoftimi me nr. UG 416862 ; -----

**BLERES :** Diana Labo , i bija e Nesimit , dtl. 1970 , lindur e banues ne Fier , njohur nga pasaporta me nr. 0268110 ; -----

te dy palet madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , te cilet me deklaruan : ---

Une shitesi Hasan Laba jam ortak i vetem i sh.p.k. " COLOMBO " me qender ne Fier , te regjistruar prane Gjykates se rrethit Tirane me nr. 9826 date 21.03.1995 dhe nr.9826/1 date 03.02.1998 . Vlera ime e kapitalit ne kete shoqeri eshte ne masen 100 % dhe ne leke kap shumen prej 10.000.000 leke. Kete pjese te kapitalit une jam dakort tja shes Diana Labo ne shumen prej 10.000.000 leke , shume te cilen ma ka dhene njeheresh ne dore jashte kesaj zyre noteriale dhe qe nga ky cast une heq dore vullnetarisht nga shoqeria si dhe nga detyra e administratorit te saj . -----

**D**iana Laba, 56 vjeçe, është administratore dhe aksionere e vetme e kompanisë së ndërtimit Colombo. Zonja Laba ia bleu kompaninë me lekë në dorë për 100 mijë euro Hasan Labës, i shfaqur si babagjysh në fshatra duke dhuruar gjela deti. Gjatë 10 viteve të fundit, kompania Colombo ka përfituar mbi 40 milionë euro nga buxheti i shtetit, në bashkëpunim me kompani të tjera, përmes tenderave të dyshimtë, shumica të shënjuar me flamur të kuq korrupsioni.

Aktiviteti financiar i kompanisë Colombo bazohet plotësisht tek paratë publike, ndërsa kompania nisi të lulëzojë në tendera pas vitit 2013, që përkon me ndryshimin e pushtetit dhe vendosjes së fijeve korruptive me linjat e duhura, kryebashkiakë, dhe drejtorë të sektorëve të rëndësishëm. Vlora, Durrësi dhe Tirana janë tre njësitë kryesore vendore, në të cilat fierakja e Colombës ka përfituar numrin më të madh të tenderave me flamur të kuq.

Disa raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe sinjalizime konfirmojnë se Colombo është kompania më problematike dhe

## Me te lexuarat

- Skandali/ Shefin e Komisaritit të Fushë-Krujës Elton Shahinin e rrahin me shuplla në masë të SHK hap klinikë kundër plakjes në emrin e Arlinda Mekos (kontabilistja e RSH-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të saj Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit Me goditje me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisaritit të Krujës për v...

në listën e zezë sa i takon mashtrimit me zbatimin e kontratave publike, përmes situacioneve false për punime që nuk ekzistojnë. Krahas përfitimit të tenderave në disa raste me letra false, me mjete dhe kapacitete fiktive shtesë për shkak të angazhimit në zbatimin e kontratave të tjera publike, me pazar në tavolinë dhe oferta fituese sa fondi limit, Diana Laba rezultoi e përfshirë në certifikimin e punëve të pakryera, me qëllim vjedhjen e parave publike, ndoshta për të kompesuar edhe tarifa rryshfeti që mund të ketë paguar tek titullarët e autoriteteve kontraktore.

Në disa raste flagrante, kompanisë Colombo i është kërkuar të kthejë paratë e përfituara në mënyrë të paligjshme me situacione false. Përplasjet janë zhvendosur edhe në gjykatë. Paratë publike të përfituara përmes mashtrimit dyshohet se janë investuar në pasuri të paluajtshme dhe jetë luksi. Mashtrimi me zbatimin e kontratave publike, me punë që ekzistojnë vetëm në letra, kthyer në praktikë, nuk mund të realizohet nga Diana Laba pa bashkëpunimin e kompanisë që mbikqyr punimet, ortakët në tenderin e fituar dhe pa titullarin e autoritetit kontraktor.

Përpos Diana Laba, në këtë skemë manipulimi, mashtrimi dhe korrupsioni me tenderat publikë shfaqen personazhe si **Shkëlqim Fusha**, i pandehur nga SPAK për korrupsion, **Nazif Bajrami**, i skeduar për trafik droge në Zvicër, **Ded Malutaj**, i arrestuar për manipulim të procedurave tenderuese, **Rrok Gega**, i dënuar për mashtrim dhe evazion fiskal, **Nuri Balla**, **Sandër Shpati**, **Arben Çela**, **Shpëtim Varaku**, **Florjan Muha**, **Dashnor Sinani**, **Behexhet Uruçi**, **Shkëlqim Aliaj**, **Luan Bali**, **Lavdimir Baraj**, **Neim Beqiraj**, **Jani Qosja** dhe **Ferdinand Çausi** me dosje në SPAK.

Tenderat për kompaninë Kolombo janë firmosur nga **Dritan Leli**, **Emiriana Sako**, **Ilir Aliaj**, **Guri Nuhaj**, **Qerim Ismailaj**, **Arlinda Pogaj**, **Dritan Agolli**, **Olsi Isufaj**, **Brunilda Mersini**, **Alfred Mullaraj**, **Eriselda Sefa**, **Irland Sina**, **Arif Tafani**, **Përparim Shametaj**, **Edvin Palloshi**, **Vangjush Dako**, **Asim Sula**, **Mejvis Kola**, **Aurora Hyka**, **Gelardina Prodani**, **Dorian Xhelili** etj.

*-Po kush janë kompanitë mbikqyrëse të punimeve, të cilat kanë lejuar kompaninë Colombo të vjedhë paratë publike përmes situacioneve të rreme për punime që nuk ekzistojnë?*

*-Kush janë personazhet që fshihen pas kompanive supervizore, të cilat janë çelësi i përvetësimit të parave publike përmes situacioneve false dhe punimeve jo cilësore? Vijon...*

TAG:

Bashkia dures

Bashkia vlore

Colombo

Diana laba

Kontrata abuzive

mashtrim me punimet

Situacione false

Tendera

Të ngjashme






**Raqka i Korçës skemë abuzimin me gruan e tij Frosela Filo me projektin e BE për furnizimin me ujë, korrupsioni me Maksin e Plehrave, aferat me tend...**



**Porti i Durrësit drejt zhvendosjes, por Liburn Ali nuk ndalon tenderat, miliona euro për godinat që priten të braktisen**



**Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Elbasanit**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

**KREU INVESTIGIM**

**KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË**

**KRYESORE POLITIKË EKONOMI**

**ANALIZË RAJON KULTURË SPORT**



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.